



Pranuar / Dërguar Prijmljeno / Predato Received / Delivered	31.03.2023	3	viti god Year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicitina Quantity
SKMESHCK	3232	/2023	1/4



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.457/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtare, me Vjollca Sinani - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, në lidhje me ankesën A.nr.457/2023 të datës 06.03.2023 të parashtruar nga ankuesi

kundër organit të punësimit Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike "Kërkesë nga Marrëdhënia e Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 16 paragrafin 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 31.03.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.457/2023 e datës 06.03.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi në pozitën sipas Ndryshimit dhe plotësimit të Akt emërimit të datës 07.05.2015 në pozitën Drejtor i drejtoratit për çështje administrative të regjistrimit të bizneseve për çështje juridike dhe praktike në Agjencinë për Regjistrim të Bizneseve në Kosovë më datë 17.05.2021 me vendimin me nr.3745 Ministria e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë e cakton në pozitën zëvendësues i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës. Me datë 24.02.2023 Ministria e Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ka nxjerr Vendimin Nr.01/09, sipas së cilit nëpunësen P.P cakton zëvendësuese të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës dhe njëkohësisht e shfuqizon vendimin me nr.3745 të datës 17.05.2021.

I pakënaqur me Vendimin Nr.01/09 të datës 24.02.2023, me datën 06.03.2023 ka parashtruar ankesën me numër protokolli 457/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore për shkak të shkeljeve të dispozitave të Legjislacionit të Shërbimit Civil, shkeljeve të dispozitave të Ligjit të Procedurës Administrative si dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit te organi i punësimit, ndërsa ky i fundit më datë 22.03.2023, ka dërguar përgjigje në ankesë së bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke i shqyrtuar shkresat e lëndës ka konstatuar që ankesa e ankuesit, është e palejuar, **SEPSE:**

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka analizuar dispozitat ligjore me rastin e caktimit të ankuesit në pozitën e zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës nga e cila pozitë është larguar tash dhe që është objekt i kësaj ankese dhe bazuar në provat që ndërlidhen me këtë çështje ka konstatuar se ankuesi ishte caktuar Zëvendësues i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës më datë 17.05.2021 bazuar në Ligjin Nr. 06/ L-113 për Organizimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura pa specifikuar ndonjë dispozitë të caktuar të këtij ligji që rregullon çështjen e zëvendësuesve të pozitave të përkohshme ndërlidhur me këtë çështje kolegji konstaton se përmbajtja e vendimit kur është caktuar ankuesi në pozitë të zëvendësuesit më datë 17.05.2021 është e njëjtë me përmbajtjen e vendimit të datës 24.02.2023 që është objekt i kësaj ankese me përjashtim të specifikimit të dispozitave të Ligjit Nr. 06/ L-113 për Organizimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura në pjesën e hyrjes së këtij vendimi, ndërsa kolegji i këshillit ka konstatuar se ankuesi këtë pozitë e kishte mbajtur deri më datë 24.02.2023 përkundër që vendimi i datës 17.05.2021 mbi të cilin kishte kryer detyrën e zëvendësuesit të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës nuk kishte ndonjë bazë të qëndrueshme ligjore, nga se për faktin se kjo pozitë është e lirë dhe se procedura e plotësimit të kësaj pozite duhet të bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe se ky është obligim ligjor i institucioneve shtetërore, por se kolegji i këshillit nuk u lëshuar në vlerësimin e ligjshmërisë së këtyre vendimeve nga se nuk ka mundur të vërtetoj me asnjë provë se ankuesit i është cenuar ndonjë e drejtë apo interes i ligjshëm në këtë proces, nga se kjo çështje sa i përket të drejtës në ankesë në rast të cenimit të ndonjë të drejte është e rregulluar në dispozitën e nenit 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se: "3.Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejt në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji...".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave sa i përket çështjes që është objekt i kësaj ankese, në kuptim të përcaktimit të së drejtës për të qenë palë në një procedurë administrative i'u referua nenit 14 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: "1. Palë në procedurën administrative mund të jetë çdo person fizik, person juridik apo grup personash me

një interes të përbashkët: 1.1. me kërkesë të të cilit organi publik ka filluar procedura administrative; 1.2. ndaj të cilit ka filluar procedura administrative apo të cilit rezultati i procedurës administrative mund t'i cenohet të drejtat apo interesat juridike.....". Ndërsa me nenin 124 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përcaktohet legjitimimi, shkaqet dhe mjetet juridike administrative, ndërsa paragrafi 1 i këtij neni përcakton që: "1.Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim.....", kështu që, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka konstatuar se vendimi i kontestuar me ankesë nuk cenon ndonjë të drejtë apo interes të ligjshëm të ankuesit, për faktin se ankuesi mbanë pozitën që kishte sipas Ndryshimit dhe plotësimit të Akt emërimit të datës 07.05.2015 në pozitën Drejtor i drejtoratit për çështje administrative të regjistrimit të bizneseve, duke pasur parasysh dispozitat ligjore që rregullojnë shërbimin civil përkatësisht Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë se marrëdhënia e punës krijohet me aktin e nënshkrimit të aktemrimit dhe se çdo cenim i ndonjë të drejte që parashihet në këtë dokument zyrtarë/aktemrim, i jep të drejtë secilit që atakohet në ndonjë formë përmes ndonjë veprimi administrativë që të ndërmer veprimet përkatësisht të përdorë mjetet juridike për të mbrojtur një të drejtë të caktuar që i garantohet me ligj, ndërsa në rastin konkretë kolegji i këshillit nuk ka hasur në ndonjë veprim që cenon interesin juridik nga marrëdhënia e punës që garantohet në përmbajtjen e sipas Ndryshimit dhe plotësimit të Akt emërimit të datës 07.05.2015 në pozitën Drejtor i drejtoratit për çështje administrative të regjistrimit të bizneseve, e mbi këtë bazë edhe për të qenë palë në këtë procedurë mbi bazën e cenimit të ndonjë interesi të ligjshëm përmes veprimit të organit përkatës që është atakuar përmes kësaj ankese, andaj kolegji i këshillit konstaton se është obligim ligjor që institucionet shtetërore me rastin e zëvendësuesve për pozitat e lira të respektojnë dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë nga se çdo shmangie nga këto dispozita dhe legjislacionin tjetër që rregullon këtë çështje mund të rezultojë me pasoja juridike për institucionin përkatës, titullarin e të njëjtit dhe zyrtarët tjerë kompetentë, mbi këto baza ligjore të specifikuara si më lartë ankesa e ankuesit është e palejuar.


Bazuar në at që u tha si më lartë dhe duke iu referuar nenit 129 paragrafit 1 nën paragrafit 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËSF PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.457/2023, datë 31/03/2023

Vjollca Sinani


Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI


Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Ministrit të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrjes dhe Tregtisë;
- Udhëheqëses së Njesisë të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrjes dhe Tregtisë ;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

